



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëpunë/Prodato Received/Delivered	16.06.2021	viti god year	2021
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Pr. Prot. Pr. Prot. Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM&HCK	3137/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.326/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Zyle Millkau Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vendosur sipas Aktgjykimit A.nr.514/20 të datës 28.04.2021 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën e datës 13.07.2020 me numër A.nr.187/2021 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kompensim material” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa A.nr.187/2021 e datës 13.07.2020 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi ka lidhur kontratën e marrëdhënies së punës me numër 541 të datës 01.08.2019 në vendin e punës “Zyrtar i Lartë për Integritet Evropian” në Departamentin për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, sipas marrëveshjes për Bursë 2016/2017, e lidhur në mes Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria për Integritet Evropian dhe se kjo kontratë lidhet për periudhë tre vjeçare (3), ankuesi me datë 01.06.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Ministri të Punëve të Brendshme për kompensimin e shtesës në vlerë prej 250 euro në muaj, sipas Vendimit Nr.03/82 të datës 04.07.2012 dhe Vendimin me Nr.08/170 të datës 14.02.2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk vendos për ankesën e ankuesit të datës 01.06.2020 dhe më datë 13.07.2020 ankuesi ka parashtruar ankesë me numër protokoll: 1351/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës në vlerë prej 250 euro në muaj, sipas Vendimit Nr.03/82 të datës



04.07.2012 dhe Vendimin me Nr.08/170 të datës 14.02.2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 12.08.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 12.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.514/19, të pranuar me datë 30.04.2021, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 12.08.2020 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos lidhur me ankesën e paditësit të datës 13.07.2020.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Aktgjykimit A.nr.514/20 të datës 28.04.2021 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën me Nr.Prot:1351/2020 të datës 13.07.2020 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në E-mail e datës 21.05.2021 sipas kërkesës së datës 15.07.2020 të KPMSHCK-së; Përgjigje e Ministria e Punëve të Brendshme e datës 04.02.2021, për ankuesin nr. protokolli 417/21, me provat e bashkangjitura si në vijim: Vendimin Nr.03/82 i datës 04.07.2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Vendimin Nr. 08/170 të datës 14.02.2014; Kërkesë nr.013 për lejimin e pagës shtesë e datës 14.01.2020; Kërkesë nr.618 e datës 09.09.2019; Kontratë e Marrëdhënies së punës Nr. 541 e datës 01.08.2019; Formularin i të dhënave për listën e pagave i datës 09.09.2019; Lista e pagave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi *është pa bazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar që ankuesi ka krijuar marrëdhënie punë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për periudhë tri (3) vjeçare, bazuar në Marrëveshjen për Bursë të lidhur në mes të Zyrës së Bashkimit Evropian dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, sipas Kontratës së Punës me numër protokolli 541 të datës 01.08.2019 në pozitën „Zyrtar i Lartë për Integritim Evropianë” në Departamentin për Integritim Evropianë dhe Koordinim të Politikave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ankuesi më datë 01.06.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 221/20 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme për mos njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës në vlerë prej 250 euro në muaj, sipas Vendimit Nr.03/82 të datës 04.07.2012 dhe Vendimit me Nr.08/170 të datës 14.02.2014 të Qeverisë së



Republikës së Kosovës, si dhe ka kërkuar kompensimin në mënyrë retroaktive nga data e themelimit të marrëdhënies së punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke u bazuar në dëshmitë e ofruara nga ankuesi dhe Organi i punësimit, ka konstatuar që ankuesi marrëdhënien e punës e ka themeluar sipas Kontratës së Punës me numër protokolli 541 të datës 01.08.2019 në pozitën „Zyrtar i Lartë për Integritet Evropianë“ në Departamentin për Integritet Evropianë dhe Koordinim të Politikave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa me datë 01.06.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë së Punëve të Brendshme, jashtë afatit të përcaktuar ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh për parashtrimin e ankesave, respektivisht ankesa është parashtruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 8 paragrafit 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, ku është përcaktuar se: *“Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”*, sepse në rastin konkret momenti kur ankuesit i ka filluar të rrjedhë afati ligjor për ankimim është atëherë kur ankuesi në xhirollogarinë e tij nuk e ka pranuar shtesën në vlerë prej 250 eurove sipas Vendimit Nr.03/82 të datës 04.07.2012 dhe Vendimit me Nr.08/170 të datës 14.02.2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjegjësisht nga data 01.09.2019. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se në rastin konkret ankuesi ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e ka parashtruar pas kalimit të afatit tridhjetë ditor (30), me çka nënkuptohet se është jashtë afatit ligjor për parashtrimin e ankesave.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.326/2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së